



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE
I SANKSIONEVE

Data: 20.04.2021

Nr: 24

VENDIM

PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 12 DATË 15.03.2021, TË PARTISË DREJTËSI, INTEGRIM DHE UNITET (PDIU) ME OBJEKT “KUNDËRSHTIMIN E VENDIMIT NR. 224, DATË 13.04.2021 TË KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 20.04.2021, me pjesëmarrjen e:

Elvin LAKO	-	Kryesues
Elvis ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan RUSMALI	-	Anëtar
Koli BELE	-	Anëtar
Ledio BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet, përfaqesuar nga z. Shkëlqim Sulo;

OBJEKT: Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 12, të Partisë Drejtësi, Integrim dhe Unitet me objekt “Kundërshtimin e vendimit nr. 224, datë 14.04.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për shqyrtimin e raportit të Autoriteti të Medias Audiovizive të pasqyrimin të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të për periudhën 26.3.2021 – 3.4.2021”, të paraqitur në KQZ në datën 15.03.2021.

BAZË LIGJORE: Nenet 21, pika 1, shkronja “b”; 78; 80; 81; 83; 84; 124; 143; 144; 171 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe Vendimi nr. 2, datë 30.01.2021 të Komisionit Rregullator “Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të medias audio dhe audiovizive”.



Rrethanat e çështjes:

1. Në datën 06.04.2021, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) ka marrë vendimin nr. 51, ku ndër të tjera ka konstatuar mosrespektim të kërkesave ligjore të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe i ka propozuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) marrjen e disa masave konkrete, ndër të cilat përmenden:
 - Për disa Ofrues të Shërbimit Mediatik (OSHMA) ka propozuar marrjen e masave administrative, për shkak të mos depozitimit nga ana e tyre të regjistrimeve për periudhën 26.03.2021 – 03.04.2021 në respektim të nenit 85, paragrafi 6 të Kodit Zgjedhor;
 - Për subjekte të tjera audiovizive të cilët kanë depozituar regjistrime jo për të gjitha ditët e kësaj periudhe, AMA i propozoi KQZ-së t/u tërhiqte vëmendjen OSHMA-ve për të respektuar këtë detyrim;
 - AMA i ka propozuar KQZ-së që ti drejtohet OSHMA-ve të caktuara për ndërprerjen e menjëhershme të transmetimeve të përmbajtjeve informative të një OSHMA-je tjetër;
 - Një propozim tjetër i bërë nga AMA ishte kërkitimi nga kjo e fundit drejtuar OSHMA-ve që të ndërpresin transmetimin e reklamave politike jashtë intervaleve kohore të përcaktuara nga neni 84, paragrafi 4 dhe 5 i Kodit Zgjedhor, si dhe ndërprerjen e transmetimit të reklamave politike brenda edicioneve të lajmeve të cilat nuk mund të sponsorizohen;
 - AMA i ka propozuar KQZ-së që ti kërkojë subjektit audioviziv RE.AL ndërprerjen e transmetimeve të reklamës politike për subjektin zgjedhor partia Bindja Demokratike, pasi ka transmetuar 283.6 minuta reklame politike, duke shkelur kufirin prej 10 minutash për të gjithë fushatën zgjedhore, të vendosur nga neni 84, pika 9 të Kodit Zgjedhor;
 - Për sa i përket raportit të përfaqësimit gjinor në fushatë, AMA i ka propozuar KQZ-së t’u tërheqë vëmendjen OSHMA-ve që të jenë më të ndjeshëm dhe të vëmendshëm në zbatim të këtij kriteri.
2. AMA i propozoi KQZ-së ndër të tjera edhe që OSHMA-të të bëjnë kompensimin me kohë transmetimi në edicionet e lajmeve për balancim, në zbatim të nenit 81 të Kodit Zgjedhor. Neni 81 i ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, parashikon se *në minutazhin politik të edicioneve informative, radiotelevizioni publik është i detyruar të zbatojë raporte kohore të barabarta për të gjitha partitë parlamentare, që në zgjedhjet e fundit për Kuvendin kanë marrë deri në 20 për qind të vendeve në Kuvend. Partitë që kanë marrë më shumë se 20 për qind të vendeve në Kuvend, përfitojnë kohë transmetimi të shpërndarë në mënyrë të barabartë midis tyre. Secila nga këto parti përfiton kohë sa dyfishi i kohës që përfiton një parti që ka marrë deri në 20% të vendeve në Kuvend. Ky detyrim vlen edhe për subjektet audiovizive private.*

3. Referuar vendimit nr. 51, datë 06.04.2021 të AMA-s, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) mori vendimin nr. 224, datë 13.04.2021, ku vendosi:
- T'u tërheqë vëmendjen, për respektimin e plotë të detyrimit ligjor për të depozituar pranë AMA-s regjistrime për periudhën 26.3.2021 – 3.4.2021, në zbatim të pikës 6, të nenit 85, të të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të nenit 8, të vendimit nr.2, datë 30.1.2021, të Komisionit Rregullator, “Për Metodologjinë e Monitorimit të Medias Audio dhe Audiovizive”, nga ofruesit e shërbimit mediatic audioviziv;
 - Ndërprerjen e transmetimit të reklamave politike jashtë intervaleve kohore të përcaktuara, në zbatim të nenit 84, pikat 4 e 5 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, për disa nga OSHMA-të
 - Të ndërpritet menjëherë transmetimi i reklamave politike brenda edicioneve të lajmeve, në zbatim të pikës 1, të nenit 84, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar për disa OSHMA;
 - Subjekti televiziv RE.AL në zbatim të pikës 9, të nenit 84, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të ndërpresë transmetimin e reklamës politike për subjektin zgjedhor Partia Bindje Demokratike;
 - Të bëjnë kompensim me kohë transmetimi në edicionet e lajmeve për balancim, në zbatim të nenit 81, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, disa nga OSHMA-të, duke mos përfshirë Partinë Drejtësi, Integrim dhe Unitet ndër partitë që përfitojnë kompensim.
4. KSHZ e arsyetoi vendimmarrjen e tij për kompensimin e minutazhit bazuar në nenin 65, pika 3 të Kodit Zgjedhor, që përcakton se të drejtat dhe detyrimet që ky ligj përcakton për subjektet zgjedhore përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit. Në kuptim të kësaj dispozite, PDIU garon në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021 si pjesë e koalicionit Partia Demokratike Aleanca për Ndryshim PD-AN dhe të drejta dhe detyrimet që ligji ia njeh partisë parlamentare PDIU përmbushen nga koalicioni. Në zbatim të dispozitës ligjore të sipërcituar Komisioneri vendosi që të përjashtojë PDIU nga përfitimi i kompensimin me kohë transmetimi në edicionet e lajmeve për balancim.
5. Kundër kësaj vendimmarrjeje të KSHZ-së paraqiti ankim subjekti ankues Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU). Ankuesi pretendon se vendimi nr. 224/2021 i KSHZ-së është në kundërshtim me Kodin Zgjedhor. Sipas subjektit ankues, KSHZ, në mënyrë të paligjshme argumenton se neni 65, pika 3 i Kodit Zgjedhor përcakton se të drejtat dhe detyrimet që ky ligj përcakton për subjektet zgjedhore përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit.

6. Në ankimin e saj, PDIU ka parashtruar se referuar vendimit nr. 555, datë 26.07.2021 të KQZ-së, PDIU ka fituar 3 mandate në Kuvend, pra kemi të bëjmë me një parti parlamentare që ka marrë deri në 20% në Kuvend.

Ankuesi pretendon gjithashtu se KSHZ bie ndesh me vendimin e tij nr. 170, datë 13.03.2021 ku ka vendosur që *“partive parlamentare të cilat në zgjedhjet e fundit për Kuvendin kanë marrë më shumë se 20% të vendeve në Kuvend, KSHZ i cakton një minutazh të barabartë prej jo më pak se 30 minutash në Televizionin Publik dhe po aq në Radion Publike. Për partitë e tjera parlamentare kjo kohë është jo më pak se 15 minuta në Televizionin Publik dhe jo më pak se 15 minuta në Radion Publike. Çdo parti joparlamentare që merr pjesë në zgjedhje, përfiton 10 minuta në Televizionin Publik dhe 10 minuta në Radion Publike”*.

7. Subjekti ankues sqaron në kërkesën ankimore të depozituar se në marrëveshjen e koalicionit PD-AN në të cilin subjekti ankues PDIU bën pjesë, në asnjë rast nuk ka të shkruar ndonjë detyrim për ta shmangur këtë parti nga e drejta që kanë si parti parlamentare e opozitës me më shumë se dy mandate për të përfituar minutazhin televiziv. Sipas PDIU-së, interpretimi i bërë nga KSHZ lë për të dëshiruar pasi nuk është në përputhje me parimet e Kodit Zgjedhor ku përcakton kompetencat e KSHZ-së në nenin 19.
8. Ankimi iu paraqit Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS), ku u caktua me short si relator z. Elvin Lako. Në seancën përgatitore të datës 19.04.2021 KAS-i vendosi pranimin për shqyrtim të kësaj kërkesë ankimore dhe vendosi thirrjen në seancën e shqyrtimit të ankuesit PDIU në datën 20.04.2021, ora 16:00.
9. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:
- Vendimin nr. 224, datë 13.03.2021 të KSHZ-së;
 - Vendimin nr. 51, datë 06.04.2021 i AMA-s.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve të palëve,

KAS-i konstatoi:

1. Vendimi i Komisionerit nr. 224, datë 13.04.2021 duhet ndryshuar në pikën 2 të tij, duke vendosur kompensimin e kohës së transmetimit në edicionet e lajmeve për balancim, përfshirë partinë parlamentare PDIU, sipas propozimit të AMA-s:

Nr.	OSHMA	PD	PS	LSI	PSD	PDIU
1	RTSH 1	35 min	-	34 min	40 min	40 min
	RTSH 2	5 min	-	4 min	7 min	7 min
3	TV Klan	57 min	-	61 min	73 min	73 min
4	TV Top Channel	7 min	-	20 min	20 min	20 min
5	TV Vizion Plus	33 min	-	39 min	44 min	47 min
6	RTSH 24	22 min	-	20 min	23 min	23 min
7	Klan Plus	26 min	-	17 min	25 min	25 min
8	Klan News	128 min	-	75 min	105 min	105 min
9	Top News	35 min	-	41 min	48 min	48 min
10	Kanal 7	15 min	-	14 min	19 min	19 min
11	News 24	20 min	-	28 min	59 min	57 min
12	ABC News	-	4 min	18 min	25 min	25 min
13	RTV Ora	17 min	-	12 min	22 min	23 min
14	Report TV	98 min	-	59 min	75 min	80 min
15	TV Scan	9 min	-	49 min	49 min	49 min
16	TV Ora News	22 min	-	9 min	24 min	26 min
17	TV Shijak	-	38 min	-	85 min	85 min
18	Euro News Balkans	-	5 min	25 min	49 min	49 min
19	Fax News	25 min	-	14 min	29 min	36 min
20	Syri TV	-	25 min	43 min	73 min	73 min
21	TV Apollon	21 min	-	174 min	174 min	174 min
22	TV Alpo	35 min	-	-	35 min	35 min
23	A2 CNN	18 min	-	19 min	45 min	47 min
24	TV Bulqiza	-	16 min	19 min	29 min	34 min
25	TV Berati	11 min	-	18 min	18 min	18 min
26	RE.AL	-	13 min	50 min	36 min	50 min
27	MCN TV	24 min	-	26 min	24 min	26 min
28	TV Rozafa	28 min	-	29 min	65 min	65 min
29	TV Skampa	9 min	-	49 min	49 min	49 min

Nr.	OSHMA	PD	PS	LSI	PSD	PDIU
30	Zjarr TV	-	10 min	-	55 min	55 min
31	Adria Net	-	-	17 min	17 min	17 min

2. Vendimi i Komisionerit për këtë pikë është i kundërligjshëm dhe alogjik. Kodi Zgjedhor ka parashikuar kriter specifik dhe formulë të saktë për përlogaritjen e kohës së transmetimit në radiotelevizionin publik dhe, për analogji, në radiotelevizionet private. Kriteri është qenia “parti politike e regjistruar” (pika 1 e nenit 80 të KZ). Partitë politike të regjistruara ndahen në tri kategori:

- a) parti parlamentare me më shumë se 20 për qind të vendeve në Kuvend;
- b) parti të tjera parlamentare (që nuk bëjnë pjesë në shkronjën “a” më sipër);
- c) parti joparlamentare.

Të njëjtin kriter dallues Kodi e ruan si për minutazhin falas dhe reklamën pa pagesë në radiotelevizionin publik (neni 80 i KZ), ashtu edhe për minutazhin politik të edicioneve informative në radiotelevizionin publik dhe në radiot dhe televizionet private (neni 81 dhe neni 84). Sipas kategorisë vjen dhe përfitimi. Ky është rregulli që Kodi ka vendosur për barazinë e armëve në fushatën mediatike: barazi proporcionale midis partive politike, me kriter të matshëm përfaqësimin parlamentar.

Modifikimi i kriterit ligjor dhe përjashtimi i partive të caktuara, parlamentare ose jo, nga e drejta e kohës mediatike me akt të Komisionerit e bën aktin në fjalë të paligjshëm.

3. AMA ka monitoruar kohën e transmetimit për partitë parlamentare dhe jo parlamentare, sikurse përcaktojnë nenet 80, 81 dhe 84 të KZ. Ky konkluzion del nga shqyrtimi i raportit të AMA-s dhe u confirmua nga administrata e KQZ-së në seancën e KAS-it. AMA ka monitoruar kohën e transmetimit për PD, e cila për AMA-n duhet të jetë e barabartë me kohën e transmetimit për PS, pasi që janë partitë e vetme parlamentare me mbi 20 për qind të vendeve në Kuvend. AMA gjithashtu ka monitoruar kohën e transmetimit për PDIU, e cila duhet të jetë e barabartë me kohën e transmetimit për PSD, si parti parlamentare me më pak se 20 për qind të vendeve në Kuvend. Edhe ky fakt u confirmua nga administrata e KQZ-së në seancën e KAS-it. Në asnjë rrethanë AMA nuk ka monitoruar koalicionin PD-AN, si të tillë dhe nuk e ka konsideruar kohën e transmetimit të koalicionit, as si kohë e barazvlefshme me kohën që i takon ligjërisht partisë udhëheqëse të tij, as si shumatore e kohës takuese të partive pjesëtare të koalicionit.

4. Komisioneri, ndryshe nga ligji dhe nga veprimtaria monitoruese e AMA-s, bën fjalë në vendimin e tij për kohë transmetimi të koalicionit, pavarësisht se koalicioni nuk është në listën e subjekteve përfituese sipas neneve 80, 81 dhe 84 të Kodit, pavarësisht se vetë Kodi e bën të qartë, se koha e transmetimit për koalicionin përfshihet në kohën e transmetimit të partive anëtare të tij dhe jo anasjelltas. Në pikën 4 të nenit 84 të Kodit për rastin e reklamave politike saktësohet se “reklamat politike të koalicioneve zgjedhore llogariten brenda kohës së partive politike anëtare të koalicionit”.

5. Arsyetimi i përsëritur i Komisionerit se “neni 65 pika 3 i Kodit Zgjedhor përcakton se të drejtat dhe detyrimet që ky ligj përcakton për subjektet zgjedhore përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit” dhe se “në kuptim të kësaj dispozite, ... të drejta dhe detyrimet që ligji ia njeh partisë parlamentare PDIU përmbushen nga koalicioni”, jo vetëm deformon përmbajtjen e pikës 3 të nenit 65 të KZ, por dhe e bën alogjik vendimin e Komisionerit. Pika 3 e nenit 65 është dispozitë që rregullon përgjegjësinë e partisë udhëheqëse të koalicionit në raport me të drejtat dhe detyrimet e koalicionit si subjekt zgjedhor. Të drejtat dhe detyrimet që ligji i përcakton për partitë politike (ku bën pjesë pa diskutim e drejta e kohës së transmetimit radioteleviziv), nuk mund t’i takojnë askujt tjetër, përveçse partisë politike.

Shumica ka vlerësime të ndara në lidhje me interpretimin e nenit 65 pika 3 të K.Zgjedhor të sipërcituar, interpretime këto që nuk ndikojnë në vendimmarrjen e saj. Arsyetimi kryesor vlerëson se Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve *a priori* ka mbajtur të njëjtin qëndrim si në lidhje me të drejtën e partive politike për kohën e transmetimit në edicionet e lajmeve ashtu dhe në lidhje me të drejtën e tyre për të propozuar anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV-ve. Për ne, ky është një qëndrim jo në përputhje me frymën e ligjit pasi nëse në rastin e GNV-ve kemi të bëjmë me një numër të kufizuar anëtarësh (4 anëtarë për çdo GNV), në rastin e kohës së transmetimit në edicionet e lajmeve, siç duket qartë dhe nga propozimi i AMA, por dhe nga interpretimi i neneve 81 e vijues të K.Zgjedhor, koha është individuale dhe nuk cënon të drejtën e ndonjë partie tjetër politike pjesë e ndonjë koalicioni apo jo. Nëse në rastin e GNV-ve, e drejta e një partie politike pjesëtare e një koalicioni zgjedhor do të cënonte të drejtën e një partie politike jopjesëtare të një koalicioni, në rastin e kohës së transmetimit në edicionet e lajmeve, kjo e drejtë për PDIU (si pjesëtare e subjektit zgjedhor koalicioni PD - AN) nuk sjell pabarazi apo diskriminim për partitë e tjera politike që konkurrojnë në vetë në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021. Pikërisht kjo është arsyeja se pse neni 65 pika 3 i K.Zgjedhor është i pazbatueshëm në këtë rast.

Arsyetimi alternativ vlerëson se kuptimi i Komisionerit për pikën 3 të nenit 65 është në të gjitha rastet e zbatuara prej tij i gabuar (për më shumë shih mendimin e pakicës në vendimin e KAS-it nr.20, datë 5.4.2021.

6. Komisioneri ka vepruar në kundërshtim edhe me kuptimin e tij të deformuar të dispozitës, sepse kohën e transmetimit që i takonte PDIU-së (të drejtën ligjore për kompensim) nuk ia ka dhënë për t'a përmbushur PD-së, partisë udhëheqëse të koalicionit, por ia ka mohuar tërësisht si PDIU-së, ashtu edhe koalicionit ku ajo bën pjesë. Vendimi i Komisionerit nuk ka mundur dot t'i dalë zot kuptimit të tij të deformuar të dispozitës. Nëse leximi i deformuar i dispozitës është kriteri matës, atëherë çfarë bëhet me kohën e transmetimit të konsumuar ndërkohë nga PDIU? Komisioneri duhet t'ia llogariste atë PD. Mbi këtë bazë duhet të korrigjonte kalkulimin e AMA-s për kohën kompensuese në favor të PD-së, duke e hequr ose ulur në mënyrë drastike atë. Pastaj duhet t'i jepte përgjigje pyetjes se si mund t'i llogaritet PD-së një kohë transmetimi që ka shkuar në favor të një partie tjetër (PDIU), ose se si mund të pajtohet me ligjin fakti se sipas tij PDIU ka të drejtë të marrë pjesë në zgjedhje dhe të regjistrojë kandidatë, por nuk ka të drejtë të bëjë fushatë për ta etj. Kuptimi i deformuar i dispozitës nga ana e komisionerit e bën kontradiktor dhe të palogjikshëm zbatimin e saj.
7. Fakti se Komisioneri e ka të përsëritur në një numër aktesh arsyetimin që deformon përmbajtjen e pikës 3 të nenit 65 të KZ (vendimi nr. 170, datë 23.3.2021, vendimi 193, datë 31.3.2021) dhe ato akte nuk janë kontestuar në rrugë ligjore, apo janë kontestuar pa sukses nuk e bën të ligjshëm vendimin nr. 224, datë 13.4.2021. Kodi Zgjedhor prevalon mbi aktet e Komisionerit dhe ankuesve nuk mund t'u mohohet drejtësia dhe e drejta për të kërkuar shqyrtimin gjyqësor të akteve të kundraligjshme sa herë që ato ndodhin, pavarësisht se një trupë e caktuar gjyqësore mund të ketë mbështetur Komisionerin në dëm të ligjit dhe të të drejtave të mohuara të ankuesve në raste të mëparshme.

PËR KËTO ARSYE

Për të gjitha arsyet e shtjelluara më sipër dhe mbështetur në nenet 21, pika 1 shkronja 'b', të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe mbështetur në shkronjën 'b' të pikës 1 të nenit 30 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 të Komisionit Rregullator, në emër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me shumicë votash, KAS-i,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës ankimore nr. 12, datë 15.04.2021, të paraqitur nga Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet.
2. Ndryshimin e pikës 2, të vendimit nr.224 datë 13.04.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, sipas propozimit të AMA-s.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Administrativ, Tiranë, brenda 5 ditëve nga hyrja e tij në fuqi.

Elvin	LAKO	-	Kryesues	(Kundër)
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar	
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar	
Koli	BELE	-	Anëtar	(Kundër)
Ledio	BRAHO	-	Anëtar	

Mendim Pakice

- 1- Në shqyrtimin e kërkesës ankimore nr.12, të Partisë Drejtësi Integrim dhe Unitet me objekt “Kundërshtimi i vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.224, datë 13 Prill 2021 “Për shqyrtimin e Raportit të Autoritetit të Medias Audiovizive të Pasqyrimit të Fushatës Zgjedhore nga OSHMA-të për periudhën 26.03.2021 – 03.04.2021”, të paraqitur në KQZ datë 15.04.2021, jemi kundër vendimit të shumicës për pranimin e ankimit të subjektit Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet dhe ndryshimin e pikës 2, të vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, sipas propozimit të AMA-s, ndaj ju paraqesim në vijim argumentat tona për këtë qëndrim.
- 2- Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet (PDIU) është regjistruar si subjekt zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvend të datës të 25 Prill 2021, pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me Kryetar z. Shpëtim Idrizi, me vendimin, nr. 33, datë 05.02.2021. Në datën 24.02.2021, PDIU, bashkë me 12 (dymbëdhjetë) parti politike të tjera të regjistruara pranë KQZ-së, kanë kërkuar regjistrimin e koalicionit “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim” (PD-AN) si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021. Bashkëlidhur kësaj kërkesë është depozituar edhe marrëveshja për krijimin e koalicionit ku partitë pjesëmarrëse kanë shprehur vullnetin e tyre për të qenë pjesë e këtij koalicioni dhe ndër të tjera kanë caktuar Partinë Demokratike si parti udhëheqëse të koalicionit, referuar nenit 65, paragrafi 3 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- 3- Me ndryshimet e fundit të Kodit Zgjedhor me anë të ligjit nr. 118, datë 05.10.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”, në nenin 65 është shtuar pika e tretë, e cila parashikon “*se në momentin e regjistrimit të një koalicioni zgjedhor, të gjitha të drejtat dhe detyrimet ligjore që përcaktohen nga Kodi Zgjedhor për partitë politike të regjistruara si subjekte zgjedhore, do të përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit*”. Pra, regjistrimi i PDIU-së në këtë koalicion zgjedhor së bashku me partitë e tjera, sjell si pasojë humbjen e së drejtës për të marrë pjesë në koalicion tjetër, përveç atij ku është regjistruar, dhe gjithashtu humbjen e të drejtës për të paraqitur kandidatë apo listë shumëmemërore kandidatësh jashtë koalicionit ku ajo bën pjesë.
Për këtë shkak, konsiderohet se partitë pjesëmarrëse në koalicion, përfshirë PDIU, në momentin e përcaktimit të partisë udhëheqëse të koalicionit PD-AN, si detyrim që buron nga paragrafi 3, i nenit 65, të Kodit Zgjedhor, pranojnë të delegojnë këto të drejta dhe detyrime.

- 4- PDIU, bashkë me partitë e tjera pjesëmarrëse të koalicionit kanë zgjedhur me vullnetin e tyre të lirë partinë udhëheqëse, që kjo e fundit të ushtrojë në emër dhe për interes të të gjitha partive pjesëtare të koalicionit, të drejtat dhe detyrimet që i njihen çdo subjekti politik pjesëmarrës në zgjedhje. Duke marrë parasysh se në marrëveshjen e koalicionit të depozituar pranë KQZ-së nga partitë pjesëmarrëse të koalicionit PD-AN, në pikën 3, të kësaj marrëveshjeje është përcaktuar si parti udhëheqëse Partia Demokratike, automatikisht **të gjitha të drejtat e rezervuara për partitë pjesëmarrëse të këtij koalicioni** do të ushtrohen vetëm nga kjo parti udhëheqëse. Ndër këto të drejta, përfshihet edhe e drejta për të përfituar minutazhin televiziv.
- 5- Në vendimin nr.170, datë 23.03.2021 “Për përcaktimin e kohës së transmetimit në radiotelevizionin publik, të fushatës zgjedhore të partive politike të regjistruara si subjekte për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021” të Komisioneri Shtetëror të Zgjedhjeve arsyetohet se, referuar nenit 80, pika 1, shkronja “b”, minutazhi falas ju vihet në dispozicion partive politike të regjistruara apo koalicionit bazuar në parimin e proporcionalitet të numrit të konkurrentëve në garë. Konkurrenca politike në garë matet nga numri i subjekteve zgjedhore të cilat kanë dorëzuar lista shumemërore për kandidatët për deputetë. Në përfundim KSHZ, ka vendosur caktimin e minutazhit kohor të transmetimit të partive parlamentare të subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 Prill 2021, partive politike joparlamentare, që konkurrojnë më vete apo si parti pjesëtare e koalicionit, si dhe 5 kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit, që janë regjistruar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Kundër vendimit të sipërcituar, subjekti zgjedhor Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet, nuk e ka ushtruar të drejtën e ankimit pranë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve. Pra, subjekti zgjedhor PDIU ka qenë dakord me vendimmarrjen e KSHZ.
- 6- Autoriteti i Mediave AudioVizive, me vendimin nr.51, datë 06.04.2021 “Për shqyrtimin e raportit të monitorimit të mbulimit të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të për periudhën 26 Mars 2021 – 03 Prill 2021” në zbatim të nenit 81, të Kodi Zgjedhor ku parashikohet se *“në minutazhin politik të edicioneve informative radiotelevizioni publik është i detyruar të zbatojë raporte kohore të barabarta për të gjitha partitë parlamentare, që në zgjedhjet e fundit për Kuvendin kanë marrë deri në 20% për qind të vendeve në Kuvend. Partitë që kanë marrë më shumë se 20% për qind të vendeve në Kuvend, përfitojnë kohë transmetimi të shpërndarë në mënyrë të barabartë midis tyre. Secila nga këto parti përfiton kohë sa ka dyfishi i kohës që përfiton një parti që ka marrë deri në 20 % për qind të vendeve në Kuvend”*, ka propozuar për kompensim me kohë transmetimi në edicionet e lajmeve, për balancim, edhe subjektin zgjedhor PDIU, sipas tabelës më poshtë:

Nr.	OSHMA	PD	PS	LSI	PSD	PDIU
1	RTSH 1	35 min	-	34 min	40 min	40 min
2	RTSH 2	5 min	-	4 min	7 min	7 min
3	TV Klan	57 min	-	61 min	73 min	73 min
4	TV Top Channel	7 min	-	20 min	20 min	20 min
5	TV Vizion Plus	33 min	-	39 min	44 min	47 min
6	RTSH 24	22 min	-	20 min	23 min	23 min
7	Klan Plus	26 min	-	17 min	25 min	25 min
8	Klan Neës	128 min	-	75 min	105 min	105 min
9	Top Neës	35 min	-	41 min	48 min	48 min
10	Kanal 7	15 min	-	14 min	19 min	19 min
11	Neës 24	20 min	-	28 min	59 min	57 min
12	ABC Neës	-	4 min	18 min	25 min	25 min
13	RTV Ora	17 min	-	12 min	22 min	23 min
14	Report TV	98 min	-	59 min	75 min	80 min
15	TV Scan	9 min	-	49 min	49 min	49 min
16	TV Ora Neës	22 min	-	9 min	24 min	26 min
17	TV Shijak	-	38 min	-	85 min	85 min
18	EuroNeës Balkans	-	5 min	25 min	49 min	49 min
19	Fax Neës	25 min	-	14 min	29 min	36 min
20	Syri TV	-	25 min	43 min	73 min	73 min
21	TV Apollon	21 min	-	174 min	174 min	174 min
22	TV Alpo	35 min	-	-	35 min	35 min
23	A2 CNN	18 min	-	19 min	45 min	47 min
24	TV Bulqiza	-	16 min	19 min	29 min	34 min
25	TV Berati	11 min	-	18 min	18 min	18 min
26	RE.AL	-	13 min	50 min	36 min	50 min
27	MCN TV	24 min	-	26 min	24 min	26 min
28	TV Rozafa	28 min	-	29 min	65 min	65 min
29	TV Skampa	9 min	-	49 min	49 min	49 min
30	Zjarr TV	-	10 min	-	55 min	55 min
31	Adria Net	-	-	17 min	17 min	17 min

7- Në lidhje me propozimin e vendimit të sipërcituar të AMA-s, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr.224, datë 13.04.2021, ka analizuar qartë vendimmarrjen e tij për kompensimin e minutazhit në zbatim të nenit 65, pika 3, e Kodit Zgjedhor, i cili përcakton se, *“të drejtat dhe detyrimet që ky ligj përcakton për subjektet zgjedhore përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit”*. Në kuptim të kësaj dispozite, PDIU garon në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 21 Prill 2021, si pjesë e koalicionit Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim (PD-AN) dhe të drejta dhe detyrimet që ligji ia njeh partisë parlamentare PDIU, përmbushen nga koalicioni. Në përfundim, KSHZ ka vendosur të përjashtojë PDIU nga përfitimi i kompensimit me kohë transmetimi në edicionet e lajmeve për balancim.

8- Një argument tjetër që rrëzon pretendimin e shumicës së anëtarëve të KAS-it është vendimi nr.8, datë 19.04.2021 i marrë nga Kolegji Zgjedhor i cili ka rrëzuar kërkesën e Partisë Drejtësi Integrim dhe Unitet për shkak se në zbatim të nenit 65, pika 3, të Kodit Zgjedhor përcaktohet shprehimisht se *të gjitha të drejtat dhe detyrimet që ky ligj përcakton për subjektet zgjedhore përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit*.

Përjashtim nga ku rregull bëhet vetëm nëse ligji e parashikon shprehimisht një gjë të tillë, sipas natyrës së të drejtës që diskutohet. Ky formulim është shtuar me ligjin nr. 118/2020, datë 5.10.2020 dhe për rrjedhojë si rregull i miratuar më vonë në kohë, kushtëzon dhe përcakton kuptimin e dispozitave të tjera të Kodit Zgjedhor, të cilat krijojnë përplasje me të. Duke qenë se në rastin konkret, subjekt zgjedhor garues në zgjedhje është koalicioni PD-AN, këtij i përket të gjitha të drejtat dhe detyrimet që Kodi parashikon për subjektet zgjedhore, në lidhje me administrimin e zgjedhjeve të 25 prillit 2021.

Nëse Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet do të paraqitej e vetme në zgjedhje, duke paraqitur listën e vet të kandidatëve, atëherë ajo do të gëzonte të plota të gjitha të drejtat që i njeh Kodi Zgjedhor.

9- Për sa më sipër, ne anëtarët e në pakicë vlerësojmë së kërkesa ankimore nr.12 e paraqitur nga ankuesi PDIU është e pabazuar dhe duhet të ishte rrëzuar nga Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Elvin LAKO - Kryesues

Koli BELE - Anëtar

